

Statistikat e Transportit Rrugor

Tremujori I - 2023

Tiranë, më 28 Prill 2023: Në tremujorin e parë 2023, gjatësia e rrjetit rrugor në shfrytëzim është 3.606 km, klasifikuar sipas kategorive të ndryshme, si autostradë, rrugë interurbane apo urbane dhe rrugë lokale. Rrugët interurbane dytësore zënë rreth 74,2 % të gjatësisë së rrjetit rrugor.

Gjatë tremujorit të parë 2023, janë regjistruar gjithsej 14.460 mjete te reja, nga të cilat 27 lloje mjeteve dhe 276 marka mjeteve. Në kategorinë e mjeteve të reja rrugore sipas llojit, përqindjen më të madhe ndaj numrit gjithsej të mjeteve rrugore e zënë "Autoveturat" (83,5 %) dhe "Motor" zënë (6,8 %).

Tab. 1 Mjetet e reja rrugore sipas llojit të regjistruara për herë të parë

Periudha	Tremujori I-rë 2022	Tremujori I-rë 2023	Ndryshimi në %
Autoveturë	11.120	12.080	8,6
Automjet për transport të përzier	557	500	-10,2
Motor	1.122	986	-12,1
Kamion	148	165	11,5
Autobus	83	93	12,0
Automjet për transport të veçantë	126	116	-7,9
Automjet për përdorim të veçantë	86	59	-31,4
Rimorkio për transport mallrash	29	24	-17,2
Të tjera	417	437	4,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje të INSTAT

Numri më i lartë i mjeteve të reja rrugore është regjistruar në qarkun e Tiranës, duke zënë 39,4 % ndaj mjeteve rrugore gjithsej të regjistruara në vend në tremujorin e parë 2023.

Qarqet me numrin më të vogël të mjeteve të reja rrugore janë qarku Dibër me 2,1 % dhe Gjirokastrë me 1,3 % secili ndaj mjeteve rrugore gjithsej.

Tab 2 Mjetet e reja mugore sipas qarqeve të regjistruara për herë të parë

Periudha	Tremujori I-rë 2022	Tremujori I-rë 2023	Ndryshimi në %
Gjithsej	13.688	14.460	5,6
Berat	535	565	5,6
Dibër	293	297	1,4
Durrës	2.113	2.210	4,6
Elbasan	924	919	-0,5
Fier	1.518	1.338	-11,9
Gjirokastrë	154	191	24,0
Korçë	421	529	25,7
Kukës	335	319	-4,8
Lezhë	629	597	-5,1
Shkodër	872	816	-6,4
Tiranë	5.100	5.701	11,8
Vlorë	794	978	23,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje të INSTAT

Marka “Volkswagen” është marka me qarkullim më të lartë në vend në kategorinë e mjeteve të reja rrugore me 20,4 %, e ndjekur nga marka “Mercedez Benz” me 16,3 %.

Tab 3 Mjetet e reja mugore sipas markës të regjistruara për herë të parë

Periudha	Tremujori I-rë 2022	Tremujori I-rë 2023	Ndryshimi në %
Gjithsej	13.688	14.460	5,6
VOLKSWAGEN	2.657	2.951	11,1
MERCEDEZ BENZ	2.387	2.352	-1,5
AUDI	998	1.371	37,4
FORD	963	903	-6,2
TOYOTA	846	857	1,3
DAIMLER CHRYSLER	637	536	-15,9
FIAT	443	491	10,8
BMW	463	445	-3,9
OPEL	399	340	-14,8
TE TJERA	3.895	4.214	8,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, llogaritje të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti rrugor: Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

Autoveturë - mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh, në të cilin numri i vendeve të uljes (duke përfshirë edhe shoferin) nuk e kalon numrin 9.

Autobus - mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vendeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9 vende.

Kamion - mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave.

Motor - mjet motorik i transportit rrugor me dy, tre ose katër rrota që nuk i kalon 400 kg peshë pa ngarkesë.

Rimorkio për transport mallrash - mjet rrugor për transportin e mallrave i projektuar për t'u tërhequr nga një mjet motorik i transportit rrugor.

Automjete për transport të përzier (ATP) - përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjësë, duke përfshirë dhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit.

Automjete për transport të veçantë (ATV) - mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të vecanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.

Automjete për përdorim të veçantë (APV) - mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të vecantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhë, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash